



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 561/1 Prot.

Tiranë, më 30 / 03 / 2021

### V E N D I M

#### Nr. 51, Datë 30 / 03 / 2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën me nr. 163 Regj., datë 30.12.2020, të E. K, kundër Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “*bindjes politike*<sup>3</sup>” dhe “*çdo shkak tjetër*<sup>4</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, E. K ka qenë në marrëdhënie pune me Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK) Shkodër, nga data 01.10.2008 deri me datë 30.11.2019.

Në parashtrimet e tij, subjekti ankues ka pretenduar se nga fundi i vitit 2018 ka refuzuar të firmosë disa fatura dietash dhe karburanti, pasi një veprim të tillë e ka vlerësuar si shkelje ligjore nga ana e titullarit dhe për këtë arsye ai shprehet se është ndëshkuar duke u transferuar si specialist në qytetin e Lezhës, pa asnjë motivacion apo shpjegim lidhur me të. Ankuesi citon se: “*Në lidhje me rastin por dhe në disa raste të tjera të shkeljeve të titullarit të DRTK Shkodër, kam njoftuar Ministrinë e Kulturës dhe nga ana tyre është ngritur një grup inspektimi, të cilët pas kontrollit të bërë në DRTK*”

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

<sup>3</sup> Referuar kartës së anëtarësimit në subjektin politik Parta Demokratike, ankuesi ka provuar bindjet e tij politike.

<sup>4</sup> Tek ky shkak ankuesi ka referuar konfliktin e krijuar mes tij dhe titullarit të Institucinit për shkak të moszbatimit të urdhrave të kundraligjshëm të tij.

*Shkodër konstatuan shkelje nga titullari. Por për ironi, raporti final humbi dhe kjo vërtetohet edhe me e-mailin që Ministria e Kulturës më ka dërguar mua”.*

Duke mos pasur dijeni për motivacionin, ankuesi ka bindjen se transferimi i tij ka ardhur si hakmarrje e punëdhënësit për shkak të mos zbatimit të urdhrave të paligjshëm për firmosjen e faturave fiktive të dietave, si dhe për shkak të bindjeve të tij politike, të ndryshme nga ato të titullarit të institucionit. Ky veprim është përshkallëzuar më tej duke e larguar përfundimisht z. K nga puna.

Ankuesi ka pretenduar se është diskriminuar nga ana e punëdhënësit lidhur me transferimin e tij, largimin përfundimtar nga puna, si dhe përjashtimin e tij nga e drejta për konkurim në vendet e lira të punës, përmes mos shpalljes së pozicioneve të lira.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë diskriminim të tij për shkaqet e pretenduara, nga ana e DRTK Shkodër, si dhe rivendosjen e të drejtave të cënuara.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së<sup>5</sup>, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010, i ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

<sup>5</sup>Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 99 prot., datë 13.01.2021, Komisioneri ka njoftuar DRTK Shkodër dhe ka kërkuar informacion dhe dokumentacion provues lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

Nëpërmjet shkresës me nr. 16/1 prot., datë 28.01.2021, DRTK Shkodër, ka sjellë parashtimet e veta dhe dokumentacionin e kërkuar.

DRTK Shkodër ka argumentuar si më poshtë citohet:

*“Lidhur me transferimin e ankuesit në Lezhë:*

*E. K ka mbajtur detyrën e specialistit/juristit dhe gjatë kryerjes së saj është konstatuar mospërbushje e përsëritur e detyrave dhe afateve të caktuara për realizimin e tyre, mosrespektim i orarit të punës, të cilat kanë bërë që me shkresën nr. 225 prot., datë 14.09.2018 të jenë objekt i takimit me punëdhënësin për zhvillimin e bisedimeve për vijimin e marrëdhënieve të punës. Më pas, me Urdhrin nr. 57 prot., datë 03.10.2018 është urdhëruar zgjidhja e kontratës së punës me të. Lidhur me këtë urdhër, z. K i është drejtuar punëdhënësit me një kërkesë për prapësimin e urdhrit për zgjidhje të marrëdhënieve të punës. Në përgjigje të kërkesës së tij është ngritur një komision i brendshëm i cili e ka gjykuar të arsyeshme t’i kërkojë titullarit, rishikimin e vendimit, për shkak të arsyeve personale/familjare të ankuesit. Nëpërmjet Urdhrit nr. 5, datë 07.01.2019 të titullarit është urdhëruar anulimi i urdhrit për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me ankuesit dhe është vendosur kalimi i tij në pozicionin e specialistit në Sektorin e Lezhës. Transferimi i tij në këtë Sektor është dakordësuar nga palët me vullnet të plotë me anë të kontratës me nr. 6/23 prot., datë 07.01.2019 si dhe me kërkesën për prapësim të z. K të datës 31.12.2018, ku shprehet se: “...shpresoj që kërkesa ime të merret parasysh e të vazhdoj marrëdhëniet e punës me DRTK Shkodër, në çdo sektor të saj, ku të jetë e mundur” Transferimi i tij në Sektorin e Lezhës, bazuar në kërkesat që kishte ky sektor, është arsyetuar nga ana e titullarit si një detyrë që z. K mund ta realizonte edhe për shkak të të paturit prej tij në ngarkim të automjetit, pronë e DRTK Shkodër dhe si rrjedhojë marrjen pjesë në të gjitha inspektimet e realizuara në territorin ku ky Institucion ka ushtruar juridiksion.*

*Lidhur me largimin përfundimtar nga puna:*

*Bazuar në VKM nr. 581, datë 28.08.2019 për “Funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore” janë bërë ndryshime në funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së këtyre drejtorive, duke përfshirë edhe DRTK Shkodër. Sa më sipër, DRTK Shkodër ushtron veprimtarinë në qarqet Shkodër, Lezhë dhe Kukës.*

Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit me nr. 139, datë 21.10.2019 është miratuar struktura dhe organika e DRTK Shkodër. Këto ndryshime konsistojnë ndër të tjera, në bashkimin e funksioneve të Sektorit të Lezhës me Sektorin e Arkeologjisë, Arkitekturës, Artit dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore. DRTK Shkodër, në zbatim të akteve ligjore sipërcituar, ka ndjekur procedurat për reflektimin e ndryshimeve ku ndër të tjera, ka plotësuar përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për pozicionet e punës të krijuara apo të prekura nga strukturimi.

Në këtë kuadër, E. K me profesion jurist, ka qenë specialist në Sektorin Lezhë, dhe ky sektor është suprimuar dhe funksionet e tij janë bashkuar me Sektorin e Arkeologjisë, Arkitekturës, Artit dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore. DRTK Shkodër ka shqyrtuar me kujdes të gjitha pozicionet e punës, kërkesat specifike të tyre. Meqenëse Sektori Lezhë është suprimuar dhe funksionet e tij janë bashkuar me ato të Sektorit të Arkeologjisë, Arkitekturës, Artit dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore dhe ky sektor ka në strukturën e tij 9 (nëntë) specialistë, është analizuar pozicioni i secilit specialist.

Ky sektor kryen rilevimin e objekteve, hartimin e projekteve të objekteve, hartimin e planimetrive, hartimin e projekteve, preventivëve, zbatimin e ndjekjen e projekteve, supervizimin dhe kolaudimin e tyre.

Lidhur me sa më sipër, E. K është me profesion jurist dhe nga kërkesat specifike të pozicioneve të punës ka rezultuar se në strukturën e tij ky sektor, nuk ka nevojë për pozicionin e specialistit me profil jurist. Kjo pasi, DRTK Shkodër ka në strukturën e saj një pozicion specialist/jurist, e pozicionuar në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, i cili e përballon intensitetin e punës dhe të problematikave juridike. Ndodhur në këto kushte, DRTK Shkodër ka vendosur me vendimin nr. 311/13 prot., datë 14.11.2019 zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Lidhur me përjashtimin e z. K nga e drejta për konkurim për vendet e lira të punës, përmes mos shpalljes së pozicioneve të lira:

Pas transferimit të z. K në Sektorin Lezhë, pozicioni vakant specialist/jurist i është njoftuar Ministrisë së Kulturës, ku më pas është publikuar në DAP. Bazuar në VKM nr. 812, datë 26.12.2018 “Për punësimin e studentëve të ekselencës në Institucionet e Administratës Shtetërore, pjesë e Shërbimit Civil, për vitin 2019” është bërë përzgjedhja e kandidatit dhe ky i fundit është punësuar. Mundësia për konkurim ka qenë e hapur për të gjithë, pa përjashtuar asnjë individ. Më pas është bërë përzgjedhja bazuar në kriteret e kësaj VKM-je”.

Bashkëlidhur dokumentacionit të kërkuar, DRTK Shkodër, ka depozituar pranë KMD një kopje të Vendimit nr. 51-2020-4936 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, lidhur me pretendimet e ankuesit për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës nga ana e punëdhënësit, DRTK Shkodër.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë të ankuesit nga ana e DRTK Shkodër.**

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të

*përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankuesit, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar<sup>6</sup> dhe Kodi i Punës, i ndryshuar<sup>7</sup>, kanë saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast DRTK Shkodër, e cila duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të paligjshme, për shkaqet e pretenduara prej tij.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“ Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

*Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:*

- a) Lidhur me pretendimin e ankuesit për trajtim të padrejtë nga DRTK Shkodër, për shkak se ai nuk ka pranuar të firmosë akte shkresore fiktive (udhëtime të cilat nuk**

---

<sup>6</sup>Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

<sup>7</sup>Kështu, neni 9, pika 10 e tij, përcakton se: *“10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”.*

**janë kryer) dhe lidhur me këtë fakt ka bërë dhe kallëzim, për sa i takon transferimit të tij nga DRTK Shkodër në Sektorin Lezhë.**

Bazuar në dokumentacionin e depozituar pranë KMD-së, rezulton se:

- Nëpërmjet shkresës me nr. 225 prot., datë 14.09.2018 ankuesit i është komunikuar nga punëdhënësi njoftimi për zhvillimin e takimit me objekt vijueshmërinë e marrëdhënies së punës. Arsyeja e këtij takimi ishte: mospërbushja e përsëritur e detyrave dhe afateve të caktuara për realizimin e tyre, mosrespektim i orarit të punës, mosrealizimi i detyrave të lëna nga eprori për administrimin dhe dërgimin e informacionit në lidhje me pasuritë në menaxhim dhe pronësi-shtet, të evidentuara edhe me e-mailin datë 21.05.2018, mosrealizimi i detyrës lidhur me dhënien e mendimit për Prefekturën Shkodër, në lidhje me mbarëvajtjen e sezonit turistik, mosrealizimi i detyrës për dhënie informacioni nga Ministria e Kulturës në kuadër të reformës strukturore për vendet vakante të Institucionit, etj.
- Nëpërmjet vendimit nr. 57, datë 03.10.2018 “Zgjidhje e kontratës së punës me E. K” punëdhënësi ka zgjidhur marrëdhëniet e punës me ankuesin.
- Referuar shkresës “Kërkesë për prapësim” të ankuesit drejtuar punëdhënësit, ndër të tjera citohet: *“Po paraqes këtë kërkesë pranë Jush për prapësimin e vendimit nr. 57, datë 03.10.2018 për shkëputjen e marrëdhënieve të punës, pasi kohët e fundit kam patur problem familjare e shëndetësore dhe nuk kam qenë i aftë të kryej brenda afatit detyrat e ngarkuara. Edhe pse i vetëdijshëm për mangësitë e mija në punë, shpresoj që kërkesa ime të merret parasysh e të vazhdoj marrëdhëniet e punës me DRTK Shkodër, në çdo sektor të saj, ku të jetë e mundur, duke garantuar se tani e tutje serioziteti im në punë do të jetë në maksimum”*.
- Referuar shkresës me nr. 5 prot., datë 07.01.2019 rezulton se punëdhënësi ka urdhëruar anulimin e aktit administrative nr. 57, datë 03.10.2018 “Zgjidhje e kontratës së punës me E. K” dhe emërimin e tij në pozicionin e specialistit në Sektorin e Lezhës.

Komisioneri evidenton faktin se, pavarësisht pretendimit të ankuesit për transferim të tij në Sektorin Lezhë, në fakt jemi në kushtet e një emërimi të ri të tij (dhe jo transferimi), pasi bëhet fjalë për një pozicion tjetër pune dhe kanë ndryshuar edhe kushtet e tjera të kontratës: vendi i punës, përshkrimi i punës, si dhe paga.

Pra, sikundër evidentohet nga aktet shkresore sa më sipër cituar, emërimi i ankuesit në Sektorin Lezhë ka ardhur me kërkesën e tij, fakt i cili është formalizuar e dakordësuar edhe në kontratën individuale të punës, me datë 07.01.2019. Në këtë kontekst, Komisioneri, vlerëson se nuk kemi trajtim të padrejtë të ankuesit, ardhur për shkakun e pretenduar prej tij. Për rrjedhojë, në mungesë të këtij trajtimi, nuk kemi sjellje apo veprime diskriminuese të DRTK Shkodër ndaj ankuesit.

Komisioneri vlerëson të evidentojë faktin se ka marrë në shqyrtim pretendimin e ankuesit për sa i takon trajtimit të tij të padrejtë dhe të diferencuar gjatë procedurës së ndjekur për largimin e tij nga puna, ndërsa nuk ka shqyrtuar procedurën e ndjekur nga DRTK Shkodër, pasi referuar Vendimit

nr. 51-2020-4936, datë 20.11.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton se pretendimi i z. K për paligjshmëri të saj është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

**b) Lidhur me pretendimin e ankuesit për trajtim të padrejtë nga DRTK Shkodër, për shkak të bindjeve të tij politike, të ndryshme me ato të punëdhënësit, për sa i takon largimit të tij të padrejtë nga puna.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe provave të sjella nga palët në proces rezultoi e provuar se, subjekti ankues ka punuar pranë DRTK Shkodër për periudhën kohore nga 01.10.2008 deri më datë 30.11.2019. Rezulton se mes ankuesit si punëmarrës dhe punëdhënësit të tij janë lidhur disa kontrata të njëpasnjëshme kryesisht me afat një vjeçar, duke specifikuar:

- Kontratë individuale pune e lidhur me kohëzgjatje nga data 01.10.2008 deri me datë 31.12.2008.
- Kontratë individuale pune e lidhur me kohëzgjatje nga data 05.01.2010 deri me datë 31.12.2010.
- Kontratë individuale pune e lidhur me datë 03.01.2011, me afat të papërcaktuar.
- Kontrata me nr. 53/3 prot., datë 24.03.2014, me detyrë Specialist i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, me kohë zgjatje 9-mujore deri me datë 31.12.2014.
- Kontratë me nr. 2/7 prot., datë 12.01.2015 me detyrë Specialist/Jurist me kohëzgjatje një vjeçare deri me datë 12.01.2016.
- Me shkresën me nr. 2/7 prot., datë 04.01.2018 është lidhur një kontratë individuale pune nëpërmjet së cilës ankuesi ka punuar në pozicionin e Specialistit pranë Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.
- Nëpërmjet shkresës me nr. 6/23 prot., datë 07.01.2019 është lidhur kontrata individuale mes ankuesit dhe punëdhënësit, nëpërmjet së cilës z. K ka pranuar të punojë si Specialist pranë Sektorit të Parkut Arkeologjik Lezhë.
- Nëpërmjet Urdhrit nr. 378, datë 24.12.2014 “Për emërimin e M.L në detyrën e drejtorit të DRKK Shkodër”, konstatohet se M.L mban detyrën e titullarit të Institucionit/njëherësh dhe punëdhënësi i ankuesit që prej datës 24.12.2014 e deri aktualisht.
- Nëpërmjet shkresës me nr. 311/13 prot., datë 14.11.2019, ankuesit i është njoftuar zgjidhja e marrëdhënieve të punës me DRTK Shkodër, për të cilën ai pretendon se ka marrë dënimin me datë 07.01.2020.

Bazuar në VKM nr. 581, datë 28.08.2019 për “Funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore” janë bërë ndryshime në funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së këtyre drejtorive, duke përfshirë edhe DRTK Shkodër. Sa më sipër, DRTK Shkodër ushtron veprimtarinë në qarqet Shkodër, Lezhë dhe Kukës.

Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit me nr. 139, datë 21.10.2019 është miratuar struktura dhe organika e DRTK Shkodër, me disa ndryshime, të cilat konsistojnë ndër të tjera, në bashkimin e

funksioneve të Sektorit të Lezhës me Sektorin e Arkeologjisë, Arkitekturës, Artit dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore.

Më poshtë pasqyrohet si ka ndryshuar struktura e Sektorit të Arkeologjisë, Artit, Arkitekturës dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore dhe Sektorit Lezhë:

Sipas strukturës së datës 01.01.2014				Sipas strukturës së datës 05.12.2019			
Spektori i Arkeologjisë, Artit, Arkitekturës dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore	Nr. punonjësve	Spektori Lezhë	Nr. punonjësve	Spektori i Arkeologjisë, Arkitekturës dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore	Nr. punonjësve	Spektori Lezhë suprimuar	Nr. punonjësve
P/Spektori	1	Specialist	1	Specialist/Inxhinier	1		-
Specialist	1	Punëtor mirëmbajt.	1	Specialist/Arkitekt	1		-
Specialist	1			Specialist/Arkitekt, Restaurator	1		
Specialist	1			Specialist/Arkitekt	1		
Specialist	1			Specialist/Historian	1		
Specialist	1			Specialist/Skulptor	1		
Punëtor mirëmbajtje	1			Punëtor mirëmbajtje	1		
Punëtor mirëmbajtje	1			Punëtor mirëmbajtje	1		
				Punëtor mirëmbajtje	1		
<b>TOTALI</b>	<b>8</b>		<b>2</b>		<b>9</b>		<b>0</b>

Nga krahasimi i dy strukturave respektive, si dhe dy sektorëve sipërcituar, vërehet se, ndryshimet në strukturën organizative të Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Shkodër/ DRKK Shkodër (sot DRTK Shkodër), konsistojnë si më poshtë:

- Në ndryshimin e emërtesës së DRKK Shkodër në DRTK Shkodër.
- Në kalimin e Sektorit të Dibrës me dy punonjës, në varësi të DRTK Tiranë.
- Në suprimimin e pozicionit të Përgjegjës të Sektorit të Arkeologjisë, Artit, Arkitekturës dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore në DRTK Shkodër.
- Bashkimin e funksioneve të Sektorit Lezhë me Sektorin e Arkeologjisë, Arkitekturës, Artit dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore Shkodër.
- Me bashkimin e Sektorit Lezhë me atë të Arkeologjisë, Arkitekturës, Artit dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore Shkodër, evidentohet se pozicioni i Specialistit të Sektorit Lezhë është suprimuar dhe në Sektorin e ri, krijuar sipas strukturës së datës 05.12.2019, është



- shtuar një pozicion/punëtor mirëmbajtjeje. Po ashtu, është suprimuar pozicioni i Përgjegjës të Sektorit të Arkeologjisë, Artit, Arkitekturës dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore në DRTK Shkodër, duke u zëvendësuar me pozicionin e Specialistit/Inxhinier.
- Në të dyja strukturat e këtij Sektori, numri i specialistëve (duke përfshirë edhe atë të përgjegjës të Sektorit në strukturën e vjetër) ka mbetur i njëjtë, 7 (shtatë).
  - Evidentohet se në strukturën e vjetër nuk ka patur të specifikuar se cili duhet të ishte arsimimi respektiv për secilin pozicion si specialist, por referuar kategorisë së pagës (IV- b) nënkuptohet se kriter ishte vetëm arsimi i lartë, pa specifikuar profilin e diplomës.
  - Në strukturën e re, rezulton që krahas çdo emërimi për pozicion pune si specialist është specifikuar edhe profesioni apo lloji/profili i diplomës që kërkohet.
  - Evidentohet se në të dyja strukturat e DRTK Shkodër pozicioni specialist është trajtuar sipas kategorisë së pagave IV-b, ndërsa pozicioni punëtor mirëmbajtje është trajtuar sipas kategorisë së pagave të klasës IV.

Sektorin Lezhë është suprimuar dhe funksionet e tij janë bashkuar me ato të Sektorit të Arkeologjisë, Arkitekturës, Artit dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore dhe ky sektor ka aktualisht në strukturën e tij 9 (nëntë) punonjës.

Referuar ndryshimeve të bëra në Sektorin e Arkeologjisë, Arkitekturës, Artit dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore Shkodër, pas suprimimit të Sektorit Lezhë, sipas strukturës së datës 05.12.2019, rezulton që profili i diplomës së ankuesit/jurist nuk është në përputhje me kriteret e pozicioneve specialist që ka aktualisht ky Sektor:

- Specialist/Inxhinier.
- Specialist/Arkitekt/e (2).
- Specialist/Arkitekt-Restaurator.
- Specialist/Historian/e.
- Specialist/Skulptor.

Pavarësisht pretendimeve të ankuesit se ai ka bërë punën e punëtorit të mirëmbajtjes, Komisioneri i referohet dokumentacionit shkresor zyrtar. Në këtë kontekst rezulton se:

- Subjekti ankues nuk ka depozituar asnjë dokument nëpërmjet të cilit të provohet fakti se ai ka kundërshtuar dhe nuk ka qenë dakord me punën që realisht mund të ketë kryer në Sektorin Lezhë.
- Referuar Kontratës Individuale të datës 07.01.2019 të nënshkruar mes ankuesit dhe punëdhënësit, DRTK Shkodër, z. K ka pranuar të punojë në pozicionin e punës specialist pranë Sektorit të Parkut Arkeologjik Lezhë, me pagën mujore prej 52.000 lekësh (bruto), në përputhje me VKM nr. 545, datë 11.08.2011, lidhja nr. 5.
- Po ashtu, referuar përshkrimin të punës së ankuesit në pozicionin specialist pranë Sektorit Lezhë, detyrat kryesore të tij në këtë detyrë ishin: inspektimi dhe monitorimi i monumenteve të kulturës që mbulohen nga Drejtoria, kontrolli dhe zbatimi i punës për mbrojtjen dhe konservimin në site arkeologjike dhe monumente kulture në qarkun Lezhë.

- Bazuar në nenet 3 dhe 7 të Kontratës Individuale të datës 07.01.2019 të ankuesit, si dhe në aktet normative sipas të cilave ai është trajtuar financiarisht, dhe konkretisht VKM nr. 545, datë 11.08.2011, lidhja nr. 5, evidentohet se është trajtuar sipas kategorisë IV-b. Pra ankuesi është trajtuar në përputhje me emërimin e kontratës së punës, si specialist me arsim të lartë.
- Komisioneri vëren se, pozicioni i punëtorit të mirëmbajtje, sipas përcaktimeve të akteve normative që rregullojnë trajtimin e tij financiar, trajtohet dhe paguhet sipas klasës së IV të pagave.
- Në këtë kontekst, bazuar në sa më sipër, trajtimi i ankuesit në pozicionin e specialistit pranë Sektorit Lezhë (përfshirë edhe atë financiar) është i ndryshëm nga ai i punëtorit të mirëmbajtjes dhe nuk mund të trajtohen njëjloj.
- Subjekti ankues është emëruar specialist në Sektorin Lezhë, sipas përshkrimit përkatës për këtë pozicion pune dhe është paguar për këtë pozicion pune. Prandaj kryerja e çdo lloj pune (siç pretendohet nga z. K se ka kryer punën e punëtorit mirëmbajtës) jashtë emërtesës si specialist duhet të ishte refuzuar nga ankuesi.

Komisioneri vlerëson se, pas ndryshimit që pësoi Sektori Lezhë dhe Sektori i Arkeologjisë, Arkitekturës, Artit dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore Shkodër, pas datës 05.12.2019, ankuesi, bazuar në profilin e diplomës së tij si jurist nuk mund të emërohej në pozicionet e reja si specialist pasi ato kishin si kriter profilet e diplomave si: inxhinier, arkitekt, restaurator, historian dhe skulptor.

Po ashtu, ankuesi nuk mund të konkuronte për pozicionin e punëtorit të mirëmbajtjes duke mos qenë i tillë.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe diferencues nga ana e DRTK Shkodër.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e DRTK Shkodër, për shkakun e pretenduar nga subjekti ankues.

- c) Lidhur me pretendimin e ankuesit për trajtim të padrejtë nga DRTK Shkodër, për shkak të bindjeve të tij politike, të ndyshme me ato të punëdhënësit, lidhur me përjashtimin e tij nga e drejta për konkurim në vendet e lira të punës, përmes mos shpalljes së pozicioneve të lira.**

Në shqyrtimin e këtij pretendimi, Komisioneri konstaton se ky pretendim i ankuesit nuk qëndron, për arsytet e mëposhtme:

- Ankuesi ka profilin e diplomës dhe profesionin jurist.
- Deri më datë 07.01.2019 ankuesi mbante pozicionin e juristit pranë Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

- Me datë 07.01.2019 ankuesi është transferuar në pozicionin e specialistit pranë Sektorit Lezhë, pas kërkesës së tij<sup>8</sup>.
- Pas transferimit të ankuesit në Sektorin Lezhë, bazuar në VKM nr. 812, datë 26.12.2018 “Për punësimin e studentëve të ekselencës në Institucionet e Administratës Shtetërore” në pozicionin jurist është emëruar S.K.
- Referuar Kontratës Individuale të datës 25.03.2019 të S.K me punëdhënësin DRTK Shkodër, rezulton se ajo është emëruar në detyrën specialiste/juriste për një periudhë një vjeçare, deri më datë 26.03.2020.
- Në strukturën e re të datës 05.12.2019 ka vetëm një pozicion juristi, i cili mbulohet nga S.K, emëruar në këtë pozicion, që pas transferimit të ankuesit në Sektorin Lezhë dhe krijimit të këtij pozicioni vakant.
- Në momentin e largimit të ankuesit nga puna, pozicioni i punës specialist/jurist ka qenë i zënë nga S.K dhe për rrjedhojë nuk mund të shpallej si vakant. Në këtë kontekst, ankuesi nuk është trajtuar në mënyrë të pafavorshme apo diferencuese nga S.K pasi pozicioni i juristit ka qenë i zënë dhe jo vakant.

Sa i takon pretendimit të ankuesit se pas largimit të tij nga puna janë marrë në punë punonjës pa kualifikimin/arsimin e kërkuar, Komisioneri thekson se, sipas dokumentacionit të depozituar si nga ankuesi ashtu dhe nga DRTK Shkodër, ky pretendim rezulton i pabazuar, dhe nuk mbështetet në asnjë akt apo provë të paraqitur e të shqyrtuar nga Komisioneri.

Ndërsa, në lidhje me pretendimin e ankuesit se pas largimit të tij është marrë një punonjëse tjetër specialiste/juriste, rezulton i pavërtetë. S.K ka qenë në marrëdhënie pune me DRTK Shkodër në këtë detyrë që prej datës 25.03.2019, me afat një vjeçar të Kontratës Individuale të Punës.

Komisioneri vlerëson se, pavarësisht faktit se brenda afatit një vjeçar të kontratës së punës, për të njëjtën specialiste/juriste, për të njëjtin pozicion pune është lidhur kontratë më afat të pacaktuar, e më pas me afat 3 muaj (veprime të panevojshme e konfuze të punëdhënësit) nuk mund të konsiderohen si marrje të reja në punë, përderisa janë të lidhura brenda afatit një vjeçar dhe është operuar brenda kontratës fillestare.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

<sup>8</sup> Referuar akteve shkresore të depozituara pranë Komisionerit nga DRTK Shkodër.

Në nenin 12/1/c) të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe diferencues nga ana e DRTK Shkodër.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e DRTK Shkodër, për shkakun e pretenduar nga subjekti ankues.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/c), si dhe nenin 33, pika 10 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të E. K, për “çdo shkak tjetër” (për shkak se ai nuk ka pranuar të firmosë akte shkresore fiktive, udhëtime të cilat nuk janë kryer), nga ana e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër, lidhur me transferimin e tij në Sektorin Lezhë.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit të E. K, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër, lidhur me largimin përfundimtar nga puna, si dhe përjashtimin e tij nga e drejta për konkurim në vendet e lira të punës, përmes mos shpalljes së pozicioneve të lira.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha: Punësim  
Shkaku: Bindjet politike  
Vendim: Mosdiskriminimi